



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 354/2 Prot.

Tiranë, më 21.07.2016

V E N D I M
Nr. 86, datë 21.07.2016

*"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 354 prot., datë 22.04.2016"*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas marrjes dijeni nga informacioni i dërguar prej Bashkisë Kurbin, për disa parregullsi të konstatuara si dhe me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, me aktin nr. 354 prot., datë 22.04.2016, "Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbim civil, në Bashkinë Kurbin", ka filluar kryesisht verifikimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në këtë institucion.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Kurbin nga grupi i punës, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Institucioni u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 354/1 prot., datë 22.04.2016 "Njoftim për fillimin e verifikimit".

Nga aktet e administruara ka rezultuar se, *Bashkia Kurbin* është organ i qeverisjes vendore i konstituuar pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe organizohet e funksionon, bazuar në ndarjen administrativo-territoriale (në rubrikën *Qarku Lezhë, Qyteti Laç*), të ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Sipas përcaktimeve të ligjit të mësipërm, kjo njësi e qeverisjes vendore përbëhet nga Bashkia Kurbin me 4 (katër) Njësitë Administrative në varësi të saj, të cilat janë, Laç, Milot, Mamurras dhe Fushë-Kuqe. *(këto të fundit, ish-Komuna, të cilat janë shkrirë në të).*

Në momentin e inspektimit Këshilli i Bashkisë Kurbin, me aktin administrativ nr. 4, datë 09.02.2016 *“Për Miratimin e strukturës dhe nivelin e pagave në Bashkinë Kurbin për vitin 2016”*, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Kurbin dhe Njësie Administrative nën varësinë e saj.

Në vijim të zbatimit të këtij vendimi, rezulton se kryetari i Bashkisë Kurbin, bazuar në nenin 64, germa “j”, të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* dhe Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*, ka nxjerrë Urdhrin nr. 17, datë 19.02.2016, për miratimin dhe implementimin e strukturës dhe organigramës të këtij institucioni.

Sipas strukturës të mësipërme, në këtë bashki dhe njësitë administrative në përbërje të saj, janë në total **433** pozicione pune, ndër të cilët **59** pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil.

Në kushtet kur, nga ana e njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të institucionit, nuk ishin përcaktuar në strukturë, pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil, si dhe duke pasur parasysh faktin se mungonin përshkrimet e punës, ky numër ka dalë si analizë e grupit të inspektimit, duke u bazuar në emërtesën e pozicioneve të punës të përcaktuar në strukturën e bashkisë, detyrat funksionale që kryenin realisht, si dhe kategoritë e pagës në këto pozicione.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin nën inspektim, konstatoj se ka parregullsi të ndryshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil, ndër të cilat:

- Njësia e burimeve njerëzore e ish-Bashkisë Laç *(e cila aktualisht është organizuar si Bashkia Kurbin)* nuk është shprehur për asnjë nga punonjësit ekzistues, në lidhje me statusin e tyre të punësimit, sipas detyrimit që rrjedh prej nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*.
- Asnjë nga njësitë e burimeve njerëzore të ish-Komunave, që aktualisht janë Njësi Administrative në varësi të Bashkisë në fjalë, nuk kanë deklaruar statusin e punësimit për punonjësit që punonin në një vend pune pjesë e shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar. Referuar gërmës “c”, Kreu IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Kurbin, ka marrë funksionet e organit përgjegjës për personelin e ish-Komunave të riorganizuara pranë saj.

- Konstatohen emërimet në vende pune pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Në vijim të këtij konstatimi, Bashkia Kurbin, me shkresën nr.390/1 prot., datë 18.02.2016, drejtuar Komisionerit, në lidhje me gjendjen e marrëdhënieve të punës, të lidhura pa kryer procedurat ligjore, me akt emërimi apo kontratë, ka deklaruar 27 marrëdhënie pune të tilla. Në këtë informacion, gabimisht, janë trajtuar në këtë mënyrë nëpunësit ***** , ***** , ***** dhe ***** , të cilët rezultojnë si nëpunës civilë të konfirmuar.

Nga verifikimet e kryera në vend dhe informacionet e dërguara në rrugë elektronike nga Bashkia Kurbin, rezulton se aktualisht janë 30 punonjës, pjesë e shërbimit civil, të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit më të lartë në hierarkinë e administrimit të shërbimit civil. Konkretisht, në shkelje të ligjit, janë kryer emërimet për punonjësit, si më poshtë:

- 1) ***** , me pozicion “*Administratore e ndihmës ekonomike*”, emëruar në detyrë me aktin nr.115, datë 01.05.2016 .
- 2) ***** , me pozicion “*Përgjegjëse e burimeve njerëzore*”, emëruar në detyrë me aktin nr.85, datë 01.04.2016.
- 3) ***** , me pozicion “*Arkitekt*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 05.02.2015.
- 4) ***** me pozicion “*Inxhinieri ndërtimi*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 02.02.2015.
- 5) ***** , me pozicion “*Specialist për pyjet*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 18.05.2015.
- 6) ***** , me pozicion “*Specialist veteriner*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 20.08.2015.
- 7) ***** , me pozicion “*Specialist arsimi*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 21.09.2015.
- 8) ***** , me pozicion “*Specialist kadastrë*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 01.09.2015.
- 9) ***** , me pozicion “*Ekonomiste*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 02.03.2015.

- 10) *****, me pozicion “*Specialist i pagave dhe sigurimeve shoqërore*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 02.12.2014.
- 11) *****, me pozicion “*Administratore e ndihmës ekonomike*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 28.02.2014.
- 12) *****, me pozicion “*Administratore e ndihmës ekonomike*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 07.04.2014.
- 13) *****, me pozicion “*Përgjegjëse e sektorit të mirëqenies sociale*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 58, datë 24.03.2016.
- 14) *****, me pozicion “*Drejtor i shërbimeve publike*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 44, datë 15.03.2016.
- 15) *****, me pozicion “*Përgjegjëse e sektorit të arsimit*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 59, datë 24.03.2016.
- 16) *****, me pozicion “*Jurist urbanistike*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 18.06.2014.
- 17) *****, me pozicion “*Drejtor mjedisi*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 31, datë 15.03.2016.
- 18) *****, me pozicion “*Specialist i tatim-taksave*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 15.06.2001.
- 19) *****, me pozicion “*Specialist i tatim-taksave*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 15.08.2011.
- 20) *****, me pozicion “*Specialist i tatim-taksave*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 21.09.2011.
- 21) *****, me pozicion “*Drejtor i ndihmës ekonomike dhe mirëqenies sociale*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 29, datë 15.03.2016.
- 22) *****, me pozicion “*Administratore e ndihmës ekonomike*”, emëruar në detyrë me kontratë pune, datë 24.03.2014.
- 23) *****, me pozicion “*Drejtoreshë e financës*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 40, datë 15.03.2016.
- 24) *****, me pozicion “*Drejtor i të ardhurave*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 41, datë 15.03.2016.

- 25) *****, me pozicion “*Drejtores e burimeve njerëzore dhe juridike*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 43, datë 15.03.2016.
- 26) *****, me pozicion “*Përgjegjës i sektorit të veterinarisë, pyjeve kullotave*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 61, datë 01.03.2016.
- 27) *****, me pozicion “*Përgjegjëse e sektorit juridik*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 62, datë 24.03.2016.
- 28) *****, me pozicion “*Përgjegjës i sektorit të monitorimit të investimeve*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 63, datë 24.03.2016.
- 29) *****, me pozicion “*Inspektor terreni*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 92, datë 11.04.2016.
- 30) *****, me pozicion “*Drejtor për arsimin dhe kulturën*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 19, datë 03.03.2016.
- Rezulton se, këta punonjës aktualisht vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune me këtë institucion, sipas pretendimit të Njesisë së burimeve njerëzore, për kryerjen e detyrave për shkak të nevojave emergjente.
 - Ashtu siç vihet re në emërtimet e pozicioneve të punës më sipër, ende vijojnë të evidentohen në këtë strukturë, pozicione pune që nuk gjenden të specifikuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, të tillë si “*Arkitekt*”, “*Inxhinier*”, etj, emërtime që përfaqësojnë profesionin e punonjësit dhe jo pozicionin e punës.
 - Konstatohet se, njësia përgjegjëse nuk kishte hartuar planin e punës së rekrutimeve, “*Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbim civil, për vitin 2016*”, e po kështu, nuk u evidentua asnjë plan konkret për të zhvilluar procedurat e konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, pasi të largohen punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin.

Në datën 28 maj 2016 ka hyrë në fuqi ligji nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i cili në nenin 185, “*Dispozita kalimtare*”, përcakton se, “*Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar*”, e për këtë arsye këto procedura të nisura, do të vijojnë sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm.

Në këto kushte, bazuar në nenin 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe në nenin 155/a dhe 116/c, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i shfuqizuar, aktet administrative për emërimin e **30**

punonjësve në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të pasqyruara më sipër, të dalë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimin civil, duhet të revokohen, si akte administrative absolutisht të pavlefshme.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”; e nenin 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

T’i kërkoj njësisë përgjegjëse, që për rregullimin e ligjshmërisë, e cila rezulton se nuk është zbatuar nga institucioni, pasi ka kryer emëtime në pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil, të zbatojë detyrat si më poshtë:

1. Fillimisht, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse, të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, sipas përkufizimit të përcaktuar në nenin, 4/1/c të ligjit, nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke përfshirë rastet e përcaktuara në nenin 2, të këtij ligji. Ky proces duhet të materializohet në strukturën e institucionit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhrin, nr. 17, datë 19.02.2016, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur në këtë akt administrativ, pozicioni në shërbimin civil.
2. Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në shërbim civil për punonjësit, që rezultojnë se i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
3. Pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse për plotësimin e **30** (tridhjetë) pozicioneve të punës të zëna në kundërshtim me ligjin, duhet të ndjekë këtë rend veprimesh:

Së pari, të verifikojë nëse ndonjë prej punonjësve, nga **4** (*katër*) ish-Komunat apo ish-Bashkia Laç (aktualisht Bashkia Kurbin), të cilët kanë qenë të punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për shërbimin civil*”, i ndryshuar dhe që në kuptim të nenit 67, pika 3, të këtij ligji, gëzojnë statusin e

nëpunësit civil, i plotësojnë kërkesat për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, dhe të kryejë emërimet pa konkurrim në atë pozicion.

Së dyti, të verifikojë listën e punonjësve të liruar nga shërbimi civil, pas ristrukturimit të institucionit dhe nëse ndonjë prej tyre plotëson kërkesat e vendit të punës, për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, të emërohet në atë pozicion, pa konkurrim.

Së treti, pasi të ketë ezauruar dy hapat e parë, të shpallë procedurat e konkurimit për pozicionet që do të rezultojnë ende të lira.

4. Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2016, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimin e të cilit do të ndiqet nga përfaqësuesit e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
5. Njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktet administrative që kanë dalë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të **30 punonjësve**, si më poshtë:
 - Aktin nr.115, datë 01.05.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin “*Administratore e ndihmës ekonomike*”.
 - Aktin nr.85, datë 01.04.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin “*Përgjegjëse e burimeve njerëzore*”.
 - Kontratën e punës datë 05.02.2015, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Arkitekt*”.
 - Kontratën e punës datë 02.02.2015, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Inxhinieri ndërtimi*”.
 - Kontratën e punës datë 18.05.2015, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist për pyjet*”.
 - Kontratën e punës datë 20.08.2015, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist veteriner*”.
 - Kontratën e punës datë 21.09.2015, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist arsimit*”.
 - Kontratën e punës datë 01.09.2015, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist kadastrë*”.

- Kontratën e punës datë 02.03.2015, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Ekonomiste*”.
- Kontratën e punës datë 02.12.2014, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist i pagave dhe sigurimeve shoqërore*”.
- Kontratën e punës datë 28.02.2014, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Administratore e ndihmës ekonomike*”.
- Kontratën e punës datë 07.04.2014, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Administratore e ndihmës ekonomike*”.
- Aktin nr. 58, datë 24.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin “*Përgjegjëse e sektorit të mirëqenies sociale*”.
- Aktin nr. 44, datë 15.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Drejtor i shërbimeve publike*”.
- Aktin nr. 59, datë 24.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin “*Përgjegjëse e sektorit të arsimit*”.
- Kontratën e punës datë 18.06.2014, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Jurist urbanistike*”.
- Aktin nr. 31, datë 15.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Drejtor mjedisi*”.
- Kontratën e punës datë 15.06.2001, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist i tatim-taksave*”.
- Kontratën e punës datë 15.08.2011, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist i tatim-taksave*”.
- Kontratën e punës datë 21.09.2011, për punonjësin ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Specialist i tatim-taksave*”.
- Aktin nr. 29, datë 15.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Drejtor i ndihmës ekonomike dhe mirëqenies sociale*”.
- Kontratën e punës datë 24.03.2014, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Administratore e ndihmës ekonomike*”.

- Aktin nr. 40, datë 15.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin “*Drejtores e financës*”.
 - Aktin nr. 41, datë 15.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Drejtor i të ardhurave*”.
 - Aktin nr. 43, datë 15.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin “*Drejtores e burimeve njerëzore dhe juridike*”.
 - Aktin nr. 61, datë 01.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Përgjegjës i sektorit të veterinarisë, pyjeve kullotave*”.
 - Aktin nr. 62, datë 24.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin “*Përgjegjëse e sektorit juridik*”.
 - Aktin nr. 63, datë 24.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Përgjegjës i sektorit të monitorimit të investimeve*”.
 - Aktin nr. 92, datë 11.04.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Inspektor terreni*”.
 - Aktin nr. 19, datë 03.03.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin “*Drejtor për arsimin dhe kulturën*”.
6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil, pasi të jetë respektuar rendi i veprimeve të përcaktuara më sipër.
7. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të respektojë rregullat e përcaktuara në kreun IV “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për*

kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

Në veçanti, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (*Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- ✓ Të bëjë publik në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Kurbin, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nën ligjore, për të materializuar procedurat e rekrutimit, të tilla si:
 - Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.
 - Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
 - Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
 - Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.
- 8. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kurbin, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative që janë kryer, për zbatimin e këtij vendimi.

9. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.

10. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA